




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika c, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale me nr. 03/L-040, parimeve të Konventës për të drejtat e fëmijëve të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuar me datë 20.11.1989, nenit 33 paragrafi 6 të Ligjit për Veprimtari Hoteliere dhe Turistike nr. 03/L-168, nenit 10, të Ligjit për Kontrollin e Duhanit me nr. 04/L-156 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës Rahovecit me Nr. 569/1, dt. 16. 12. 2010, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2013, miratoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA DUKURITË QË DËMTOJNË SHËNDETIN DHE ZHVILLIMIN E TYRE

Qëllimi

Neni 1

Me këtë rregullore, përcaktohen kushtet për ndalimin e dukurive që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve, kushtet në të cilat personat fizikë dhe juridik (organizatat tregtare dhe shërbyese), mund t'u ofrojnë në shitje ose shërbime tjera që janë të ndaluara me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, e që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijëve.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Përkufizimet

Neni 2

1. **Fëmijë** - konsiderohen personat (jo madhor) nën moshën 18 vjeç,
2. **Të mitur** - konsiderohen personat prej moshës 14 deri në 18 vjeç,
 - 2.1 Personat prej moshës 14 deri 16 vjeç, konsiderohen të mitur të rinj,
 - 2.2 Personat prej moshës 16 deri 18 vjeç janë të mitur, të rritur.
 - 2.3 Personat madhor janë personat mbi moshën 18 vjeç,
 - 2.4 Dispozitat e kësaj rregullore vlejnë edhe për personat nën moshën 14 vjeçare,
3. **Dukuri negative** - konsiderohen: konsumimi i alkoolit, duhanit, narkotikëve të ndryshëm, shfaqjet degjeneruese, frekuentimi i të rinjve në lokalet e ndryshme në orët e vona etj.
4. **Vende publike** - konsiderohen hapësirat, lokalet e ndryshme hoteliere shërbyese dhe tregtare, kafiteritë, internet kafet, institucionet kulturore, objektet edukativo-arsimore, kinematë dhe lokalet e natyrës së tillë.

5. **Lokal afarist** - kuptojmë çdo biznes individual të personave fizik dhe juridik që zhvillojnë veprimtari shërbyese dhe afariste.
6. **Punësimi** – raport i punës i krijuar ndërmjet dy subjekteve për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të caktuara nga marrëdhënia e punës.

Neni 3

1. Ndalohet rreptësisht shitja dhe përdorimi i të gjithave pijeve alkoolike dhe duhanit brenda dhe jashtë hapësirave shkollore dhe në afërsi të objekteve edukativo - arsimore.
2. Të gjitha subjektet nga neni 2.4 i kësaj Rregulloreje, janë të obliguara që në hyrje apo në brendi të vendosin tabelën (shenjën) për ndalimin e shitjes dhe shërbimit të pijeve alkoolike dhe duhanit për fëmijë, konform dispozitave të kësaj rregulloreje dhe ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
3. Ndalohet shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike për të miturit nga subjektet afariste (kafiteritë, vetëshërbimet etj).
4. Ndalohet shitja dhe shërbimi me duhan apo çdo lloj tjetër i substancave që dëmtojnë shëndetin e fëmijëve, nga subjektet tregtare që merren me shitjen dhe shërbimin e tyre.
5. Të miturit e rritur mund të shesin pije alkoolike dhe duhan, vetëm në prani ose me leje dhe pëlqim të prindërve apo kujdestarit ligjor, në objektet që posedojnë leje përkatëse.
6. U ndalohet rreptësisht personave nën moshën 16 vjeçare të shesin pije alkoolike dhe duhan.
7. Ndalohet rreptësisht shtyrja e fëmijëve për të kërkuar lëmoshë.
- 8.

Obligimet e subjekteve biznesore dhe të miturit

Neni 4

1. Të miturit nën moshën 16 vjeçare, mund të qëndrojnë në lokalet në të cilat shërbehet alkooli vetëm në prani të prindit ose kujdestarit ligjor.
2. Të miturit e rritur mund të qëndrojnë deri në ora 20:00, ndërsa pas orës 20:00 vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
3. Në lokalet në të cilat zhvillohet aktiviteti si: loto, bingo, prognoza sportive, internet kafe apo lojëra fati ndalohet hyrja e fëmijëve.
4. Organizatorët e shfaqjeve të ndryshme, programeve dhe manifestimeve publike dhe kulturore për të rinjtë në lokalet e mbyllura janë përgjegjës në rast se në ato lokale lejon përdorimin e pijeve alkoolike apo duhanit nga fëmijët në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.

Kinematë, Internet kafetë dhe Shtypi

Neni 5

1. Kinematë apo subjektet tjera që merren me shfaqje publike të filmave, janë të detyruara që për fëmijët-të mitur deri në moshën 14 vjeçare të zhvillojnë aktivitetin e vet deri në ora 18:00 prej moshës 14 deri në 16 vjeçare deri në ora 20:00, ndërsa për fëmijët-të mitur prej 16 deri në 18 vjeç deri në ora 22:00.
2. Pas orës 22:00 shfaqjet e tilla të miturit, mund t'i përcjellin vetëm në prani të prindit apo kujdestarit ligjor.
3. Kinematë, apo subjektet tjera janë të obliguara që me rastin e shfaqjes së filmave, përmbajtja e të cilave ndikon negativisht në formimin e fëmijëve-të miturve në aspektin edukativ, arsimor dhe kulturor, janë të obliguar që të vendosin njoftimin se u ndalohet hyrja e fëmijëve, me rastin e reklamimit të filmit si dhe në hyrje të objektit ta kenë shenjën për ndalimin e hyrjes dhe njëkohësisht janë të obliguara që mos të lejojnë hyrjen e tyre.
4. Botuesit dhe shitësit e revistave të ndryshme, përmbajtja e të cilave është degjeneruese dhe të cilat ndikojnë negativisht në edukimin arsimor, shëndetësor dhe kulturor të fëmijëve nuk mund t'i shesin fëmijëve deri në moshën 16 vjeçare.
5. Video klubet apo subjektet që merren me shitjen e videokasetave, DVD-ve, CD-ve, përmbajtja e të cilave është degjeneruese janë të obliguara që të mos u shesin fëmijëve.

DISPOZITAT NDËSHKUESE DHE GJOBAT

Neni 6

1. Pronarët e lokaleve në të cilat shiten, ose shërbehen pijet alkoolike në kundërshtim me dispozitat nga neni 3 i kësaj Rregulloreje, për kundërvajtjen e kryer, do të dënohet me gjobë prej 500 -1.500 €, siç është përcaktuar me nenin 39 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit mbi Veprimtarinë Hoteliere dhe Turistike nr. 03/L-168 të datës 11.02.2010.
2. **Me gjobë mandatore në shumë prej 100€ do të dënohen:**
 - 2.1 Nëse të miturit i lejoheq qëndrimi në restorant apo kafiteri etj. në kundërshtim më dispozitat e nenit 4 paragrafit 1, 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.
 - 2.2 Nëse subjektet nga neni 4 paragrafi 4 veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore.
 - 2.3 Organizuesit e shfaqjeve, manifestimeve etj, veprojnë në kundërshtim me dispozitat nga neni 3 paragrafi. 4 të kësaj rregullore.
3. **Me gjobë mandatare në shumë prej 150 € do të dënohen:**

- 3.1 Nëse subjektet nga neni 3.1, veprojnë në kundërshtim me dispozita të kësaj rregulloreje do të dënohet personi përgjegjës i Institucionit Edukativo-Arsimor, nëse nuk respektohet dispozita e nenit 3.1.
- 3.2 Personi përgjegjës do të dënohet në bazë të paragrafit 3.1 të këtij neni nëse, nuk e informon me shkrim DKA-në ose Komunën.

DISPOZIATAT PËRFUNDIMTARE - KALIMTARE

Neni 7

Nëse subjektet nuk bëjnë pagesën e gjobave të shqiptuara në pajtim me dispozitat e nenit 6.2 dhe 6.3 të kësaj rregulloreje, do të iniciohet procedura për ekzekutim në Gjykatën kompetente.

Neni 8

Të gjitha mjetet e arkëtuara nga shqiptimi i masave ndëshkuese manadatore do të derdhen në Buxhetin e Komunës.

Neni 9

Për implementimin (zbatimin) e kësaj Rregulloreje do të kujdesen: Drejtoria për Inspektim, Policia e Kosovës, Koordinatorin për të drejtat e fëmijëve dhe të gjithë udhëheqësit e Institucioneve Edukativo Arsimore.

Neni 10

Kjo rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

Neni 11

Kjo rregullore hyn në fuqi tetë (8) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe publikohet në faqen zyrtare të Komunës.

01 Nr. 2577
Rahovec, 30.05.2013

Kuvendi i Komunës së Rahovecit



Kryesuesi i Kuvendit
Xhemali Haxhimustafa